

PËRDORIMI I VIDEOS NË FORMIMIN DHE ZHVILLIMIN FILLESTAR DHE TË VAZHDUAR PROFESIONAL



Kapitulli 1: Të fillojmë punën - Video - Prezantimi.....	4
Kapitulli 2: Video - Bibliotekat.....	6
Kapitulli 3: Videot Demonstruese dhe Videot Udhëzuese (<i>How-to</i>).....	8
Kapitulli 4: Intervistimi i një Profesioni.....	10
Kapitulli 5: Aksesueshmëria e Videove në Internet.....	13
Kapitulli 6: Videot Nxënëse.....	14
Kapitulli 7: Interesat e Veçanta - Përmbajtja dhe Video-Materialet Interaktive.....	15

RRETH KËTIJ MANUALI

Ky manual është krijuar për të promovuar përdorimin e materialeve filmike (video) në arsimin dhe formimin profesional.

Aktivitetet e manualit bazohen në praktikën e provuar dhe të testuar në shkolla, kolegje dhe biznese. Ky manual do t'ju ndihmojë për të përdorur videon në mësimdhënien tuaj dhe për t'i ndihmuar nxënësit tuaj të mësojnë - pavarësisht nivelit dhe sektorit.

Çdo kapitull fillon me detyrat mësimore. Detyrat kërkojnë zhvillimin e aktivitetit të vërtetë dhe, për këtë qëllim do t'ju nevojiten disa mjete teknike si një telefon inteligjent ose kamera, një kompjuter dhe një program redaktimi. Disa aktivitete të tjera mund të zhvillohen duke punuar në çift ose në një grup të vogël. Ne i inkurajojmë përdoruesit e këtij manuali elektronik që të provojnë realizimin e këtyre detyrave vetë. Mësuesit e arsimit profesional ose trajnuesit, me siguri do të përfitojnë shumë nga këto detyra nëpërmjet përdorimit të tyre si aktivitete mësimore me nxënësit. Ne iu ofrojmë disa këshilla se si mund t'i përshtatni detyrat me rezultatet e ndryshme të të nxënës, kontekstet ose llojet e nxënësve; megjithatë, ndoshta mësuesit kanë dëshirë të bëjnë ndryshime të mëtejshme në lidhje me nxënësit dhe programet e tyre.

Nëse jeni fillestarë në këtë lloj aktiviteti, mos u shqetësoni për cilësinë e videove tuaja. Qëllimi nuk është që të prodhoni video me cilësi komerciale. Qëllimi është të përfitoni sa më shumë nga videot dhe t'i përdorni ato në mënyrë të shëndoshë për qëllime pedagogjike që, në fakt, ju ndihmon juve, nxënësit dhe kolegët tuaj.

Pas çdo detyre mësimore do të gjeni një seksion i cili titullohet: Gjërat që duhen patur parasysh. Ky seksion shpjegon idenë në bazë të të cilës është formuluar secila detyrë si edhe ofron këshilla praktike.

Në këtë manual do të gjeni edhe disa sugjerime e rekomandime në lidhje me përdorimin e teknologjisë. Ne nuk hyjmë në detaje të çdo programi dhe aplikacioni. Spektri i mjeteve, formateve dhe programeve kompjuterike që lidhen me videot ndryshon në mënyrë të vazhdueshme - diçka që mund të gjendet pa pagesë në këtë moment, mund të mos jetë e disponueshme një vit më vonë. Standardet mund të ndryshojnë dhe mjetet mund të jenë në dispozicion herë më pak e herë më shumë. Ne ju rekomandojmë të kërkonit mjete të reja dhe të përshtatshme - dhe të provoni mjete të ndryshme për të kuptuar se cilat ju përshtaten më mirë. Ky manual elektronik bazohet në punën praktike, kërkimin dhe zhvillimin e video-pedagogjisë nga **Universiteti Oulu i Shkollës për Shkencat e Aplikuara në Arsimin Profesional të Mësimdhënësve dhe Instituti Federal Zviceran për Arsimin dhe Formimin Profesional**.

Ju inkurajojmë të ndani praktikën tuaj në video-pedagogji me mësuesit e tjerë të arsimit profesional. Ju mund ta bëni këtë përdorur Platformën e Video -Pedagogjisë të Fondacionit European të Trajnimit dhe duke iu bashkuar

[komunitetit të ETF për video-pedagogjinë](#) ose thjesht duke ndjekur në Twitter [@vidpedagogy](#) [#videopedagogy](#)

Fondacioni European i Trajnimit <https://www.etf.europa.eu>
[Oulu University of Applied Sciences School of Professional Teacher Education](#) (Universiteti Oulu i Shkollës për Shkencat e Aplikuara në Arsimin Profesional të Mësimdhënësve)

[Swiss Federal Institute for Vocational Education and Training](#)
(Instituti Federal Zviceran për Arsimin dhe Formimin Profesional)

Ky udhëzues u përgatit nga Janne Länsitie, Juha Pousi dhe Tommi Karjalainen nga Universiteti Oulu i Shkollës për Shkencat e Aplikuara në Arsimin Profesional të Mësimdhënësve, Finlandë, me rishikime nga Julian Stanley, ekspert i ETF. Ai u përgatit në kuadrin e një projekti më të gjerë për video-pedagogjinë, për zbatimin e të cilit ETF ngarkoi Universitetin e Oulu të Shkencave të Aplikuara në Finlandë (ref. Bler Stevenson dhe Janne Länsitie) dhe SFIVET (ref. Alberto Cattaneo dhe Alessia Evi-Colombo).

Ju lutemi citoni si më poshtë:

Länsitie, J., Pousi, J., Karjalainen, T. & Stanley, J. (2019). Përdorimi i videos në formimin dhe zhvillimin fillestar dhe të vazhduar. Fondacioni European i Trajnimit: Torino.

Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësia e vetme e autorëve dhe e ETF dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e institucioneve të BE-së.

PDF ISBN 978-92-9157-710-1 doi:10.2816/585809 TA-01-19-496-EN-N

© Fondacioni European i Trajnimit, 2019.

Teksti
JANNE LÄNSITIE
JUHA POUSI
JULIAN STANLEY
TOMMI KARJALAINEN

Dizajni
TOMMI KARJALAINEN

PËRDORIMI I VIDEOS NË FORMIMIN DHE ZHVILLIMIN FILLESTAR DHE TË VAZHDUAR PROFESIONAL

KAPITULLI 1: TË FILLOJMË PUNËN - VIDEO-PREZANTIMI

Në këtë kapitull do të merremi me elementet më bazë të punës me videon dhe audion. Qëllimi i këtij manuali është që ju dhe nxënësit tuaj të mund të përdorni video-pedagogjinë menjëherë - në mënyrë që të mësoni duke bërë. Detyrat mësimore do t'ju ndihmojnë që të mësoni se si të punoni me një pajisje video-regjistrimi, si të flisni përpara kameras dhe si të ndani videot tuaja me të tjerët.

Detyrë mësimore 1#1: Prezantoni një mjet ose një objekt pune

Rezultatet e të nxënit:

Ju

- fiksoni imazhet me sukses
- i shpjegoni të tjerëve përdorimin e një objekti pune nëpërmjet videos

Merrni një kamera ose një telefon inteligjent dhe filmoni një mjet ose një objekt pune që përdoret shpesh në profesionin tuaj. Publiku i synuar i kësaj videoje janë ato persona që nuk janë të sigurtë në lidhje me mënyrën e përdorimit të atij mjeti apo se si të fillojnë ta përdorin atë. Qëllimi juaj është t'u tregoni atyre se si funksionon. Para se të filloni, shikojeni me kujdes objektin dhe vendosni paraprakisht se çfarë doni të thoni në lidhje me të.

Nëse objekti është i vogël - vendoseni kamerën tuaj afër tij. Nëse duhet të shfaqni një plan më të madh - vendoseni atë pak më larg. Nëse duhet të shfaqni si objektin ashtu edhe sfondin, ju mund të kaloni nga një plan më i gjerë në një plan më të ngushtë duke e lëvizur kamerën më larg / më afër ose duke përdorur zmadhimin ose zvogëlimin (zoom).

Ndërsa filmoni shpjegoni me zërin tuaj se çfarë shihet dhe çfarë po ndodh. Mos e zgjasni shumë - 1 minutë duhet të mjaftojë nëse nuk është një objekt kompleks.

Alternativa të tjera

- Kërkojini një nxënësi të regjistrojë videon pa

zë dhe më pas kërkojini një nxënësi tjetër të shtojë shpjegimin me zë (voiceover).

- Specifikoni kohëzgjatjen e saktë të videos para se të filloni filmimin.
- Kushtojini vëmendje shpjegimit, p.sh. kërkojuni nxënësve tuaj të identifikojnë rreziqet ose të dallojnë dy variante të të njëjtit objekt, etj.
- Përgatisni shpjegimin me zë në një gjuhë të huaj.

Gjërat që duhen patur parasysht

Shkëmbimi i njohurive mes njerëzve të ndryshëm është një sfidë më vete. Një pjesë e mirë e informacionit humbet ose nuk përdoret apo shpërndahet në mënyrë shumë efektive - qoftë kjo përvojë, aftësi apo mendim. Sidomos në fushën e arsimit profesional ka shumë informacion që nuk mund të studiohet nëpër libra. Kjo është arsyeja pse profesionistët dhe mentorët më me përvojë janë shumë të rëndësishëm. Videoja digjitale i ndihmon punonjësit dhe profesionistët të ndajnë njohuritë dhe aftësitë e tyre me njëri-tjetrin - edhe nëse nuk punojnë përkrah njëri-tjetrit.

Edhe nevoja për video në gjuhë të ndryshme është shumë e madhe. Praktikata, mjetet dhe metodat ndryshojnë nga njëra kulturë në tjetrën. Një video në gjuhën angleze e realizuar nga një person në vendin e tij / saj nuk është domosdoshmërisht një këshillë e mirë në të gjithë botën. Videot mund të demonstrojnë dhe të tregojnë. Pjesa e tregimit mund të bëhet me titra, grafikë dhe shpjegim me zë. Videoja mund të modifikohet me lehtësi për kultura, vende, gjuhë dhe rrethana të ndryshme.

Shembull i prezantimit të një objekti në video:

- [Si të Përdorim një Kalibër Vernier](#)

Detyrë mësimore 1#2: Kërkoni mendimin e të tjerëve

Rezultatet e të nxënit:

Ju

- jepni dhe merrni mendime nga të tjerët
- vlerësoni shpjegimin
- komunikoni nëpërmjet videos

Tregojani videon që keni bërë një nxënësi tjetër. Kërkoni mendimin e tij/saj: a mund të shohë atë që duhet parë dhe të dëgjojë atë që duhet të dëgjohet?

Alternativa të tjera

- Tregojani videon një kolegu, prindi ose një punëdhënësi.
- Bazuar në ato që keni mësuar nga mendimet e të tjerëve, realizoni një video të re ku shpjegoni përdorimin e një objekti tjetër pune.



Figura 1 Ju mund të përdorni një telefon inteligjent për të regjistruar një video.

Gjërat që duhen patur parasysh

Është e rëndësishme që të përftoni përvojë praktike në lidhje me të nxënit nëpërmjet videos. Si realizimi ashtu edhe ndjekja e videove janë dy elemente të rëndësishme për të vlerësuar vlerën e këtij aktiviteti. Mësuesi mund të dëshirojë të krijojë ose të japë një shembull në mënyrë që të ilustrojë atë që pritet nga nxënësit.

Kjo detyrë i fton nxënësit dhe mësuesit të shikojnë mirë mjetet ose objektet e tjera të punës dhe të zgjedhin atë që është i rëndësishëm në përgjithësi ose në lidhje me aspekte të veçanta, të tilla si dizajni, kostoja ose përdorimi. Realizimi i një videoje shërben si një kornizë për një aktivitet mësuesor që përfshin kërkimin, organizimin, komunikimin dhe marrjen e mendimeve. Detyra mund të zhvillohet dhe të përshtatet në shumë mënyra.

Për të kursyer kohë është e mundur që të xhironi një video të vazhdueshme pa ndërprerje - në mënyrë që të mos ketë më nevojë për redaktim më vonë.

Megjithatë, zakonisht, videot përfundimtare modifikohen duke u bazuar në disa filmime.

Mendimet e të shikuesve na informojnë në lidhje me atë çfarë ata shohin dhe mësojnë nga videoja. Nuk është e pazakontë që prodhuesi i videos të shohë më shumë gjëra në video sesa ato që shikon publiku. Prodhuesi e di se për çfarë supozohet të jetë videoja. Ajo mund të duket shumë e qartë sepse truri ynë "i plotëson" imazhet që mungojnë ose pjesët e videos që janë të vështira për t'u dëgjuar. Një shikues i cili nuk e njeh procesin e mendimit mbi të cilin është bazuar prodhimi i videos e ka të vështirë të kuptojë mesazhin e plotë që përçohet nëpërmjet saj.

VIDEO - PREZANTIMI



Figura 2 Një shembull i inkuadrimin dhe përdorimit të një trekëmbëshi.

KAPITULLI 2: VIDEO-BIBLIOTEKAT

Në këtë kapitull ne analizojmë videot ekzistuese që kanë të bëjnë me një profesion të caktuar. Detyra ju ndihmon të gjeni video në lidhje me profesionin tuaj dhe t'i mblidhni ato së bashku në video-bibliotekën tuaj.

Detyrë mësimore 2.1: Videot për profesionet

Rezultatet e të nxënit:

Ju

- përdorni burime filmike (video) për të eksploruar profesionet dhe jetën profesionale
- ndani me të tjerët dhe vlerësoni informacionin filmik (video)

Hyni në internet dhe kërkoni video që lidhen me fushën tuaj profesionale. Ose përdorni tastin e kërkimit për të zgjedhur videon në motorin tuaj të kërkimit ose përdorni një term kompleks kërkimi, p.sh. [inxhinier mekanik + video](#) ose [shef pastičerie + video + italisht](#).

Përgatisni një recension të shkurtër me shkrim të pesë videove më të mira. Në secilin rast identifikoni se për çfarë bëhet fjalë dhe çfarë mund të mësoni nga videoja. Vlerësoni me pikë secilën video sa i takon lidhjes së tyre me programin tuaj mësimor dhe shkallës së motivimit për të punuar në atë profesion.

Siguroini një link për secilën video. I gjithë recensionin duhet të jetë i gjatë rreth 150 fjalë.

Alternativa të tjera

- Kërkoni një grupi ose një klase të identifikojnë videot që lidhen me profesione të ndryshme brenda një sektori ose për fusha krejtësisht të ndryshme.
- Kërkoni nxënësve të ngarkojnë recensionet e tyre në një faqe interneti ose në një komunitet në mënyrë që të përdoren edhe nga të tjerët.
- Kërkoni nxënësve të komentojnë mbi recensionet e njëri-tjetrit në internet - për të eksploruar dhe dokumentuar perceptime të ndryshme.
- Kërkoni nxënësve të krijojnë një arkiv me video në internet - videot mund të klasifikohen në lidhje me fushat profesionale ose "nën-profesionin". Kërkoni nxënësve t'i klasifikojnë videot sipas temës ose qëllimit të tyre, p.sh. rekrutim, shitje, vlerë edukative, rrjetëzim. Krijoni një listë në *YouTube* të videove të gjetura. Shembull: [Lista e videove për sigurinë në laboratorë](#).




Figura 3 Shfletimi i një video-liste.

Detyrë mësimore 2: Video-lista

Rezultatet e të nxënit:

Ju

- krijoni një video-listë
- ndani video-listën me të tjerët në mediat sociale ose në faqen e internetit

Kërkoni disa video që përmbajnë shembuj të zanatit / profesionit tuaj. Mblidhni linqet për videot e gjetura diku tjetër në një dokument të vetëm në internet ose në faqen e internetit ose krijoni një video-listë në [YouTube](#). Aty mund të gjeni edhe udhëzime se [si të krijoni video-lista](#).

Ndajeni me të tjerët linkun e video-listës në [YouTube](#) ose të dokumentit / faqes së internetit.

Gjërat që duhen patur parasys

Të nxënit tradicional përmes hulumtimit përqendrohet tek teksti. Interneti jo vetëm që ofron tekste me shumicë, por ai përmban edhe një pasuri të tërë me video që mundësojnë të nxënit në lidhje me botën profesionale. Nxënësit mund të mësohen se si të kërkojnë dhe të nxjerrin materialin e duhur filmik, si ta organizojnë, vlerësojnë dhe shpërndajnë atë. Ky material filmik më pas mund të përdoret edhe në të ardhmen.

Ai mund të shërbejë si një kontribut për prodhime të tjera ose mund të ofrojë një kornizë për ndërveprimet midis mësuesve dhe nxënësve që konvertohet në të nxënë, p.sh. diskutimi kritik, shpjegimi.

Videot mund të kenë një impakt të fortë emocional, kështu që përdorimi i tyre është veçanërisht i vlefshëm kur të nxënit lidhet me vlerat, vendimet personale dhe identitetin. Në detyrën e mësipërme fokusi ka të bëjë me të kuptuarit e roleve dhe aktiviteteve profesionale, gjë që është e rëndësishme për zhvillimin e identitetit profesional dhe realizimin e zgjedhjeve profesionale.

Rishikimi i videove ose blogjeve ose komentet në *Twitter* në lidhje me videot janë disa mënyra të tjera për të angazhuar nxënësit që të shohin dhe të mësojnë nga ato video që kanë lidhje me programet e tyre. Një video-listë është një mënyrë e përhapur për të grupuar së bashku materialet filmike që kanë lidhje midis tyre. Krijimi i një video-liste mund të jetë një detyrë bashkëpunuese që përforcon të nxënit.

Nxënësit mund të ftohen ose t'u kërkohet që të kurojnë dhe nxjerrin në pah materialet përmes blogjeve të tyre, të hedhin video dhe të krijojnë video-lista me anë të të cilave ndajnë me të tjerët videot interesante që i kanë gjetur në internet.

VIDEO-BIBLIOTEKË

Shembuj

- Video-biblioteka e British Petroleum
- Video-biblioteka për kopshtarinë
- TED - Fjalime frymëzuese

KAPITULLI 3: VIDEOT DEMONSTRUESE DHE VIDEOT UDHËZUESE (HOW-TO)

Në këtë kapitull do të merremi veçanërisht me videot udhëzuese (*how-to*) dhe si mund të na shërbejnë ato si udhëzim ose demonstrim i një aftësie ose si demonstrim i kompetencës.

Detyrë mësimore 3#1: Krijoni një video udhëzuese (*how-to*)

Rezultatet e të nxënit:

Ju

- identifikoni dhe komunikoni aftësitë
- jepni një shpjegim për t'i ndihmuar të tjerët të mësojnë
- përdorni teknologjinë për të krijuar dhe shkëmbyer një burim mësimor

Shkruani një skenar të thjeshtë për një video që do t'u tregojë shikuesve se si të kryejnë një detyrë pune. Mundohuni të përdorni vetëm një fjali për të përshkruar secilën prej skenave.

Shikoni shembuj të videove në internet nëse nuk keni informacion në lidhje me këtë lloj videoje. Shembull: [Si të Ndryshoni një Gomë B biçiklete](#).

Vendosni nëse do të flisni në video ndërkohë që regjistroni apo do të bëni një përshkrim me zë në sfond më pas. Organizoni vendin dhe të gjithë objektet që ju nevojiten për videon. Kërkojini një personi tjetër që t'ju filmojë ose përdorni një kamera të fiksuar në një mbajtëse. Filmoni të gjitha skenat që ju nevojiten. Modifikoni videon duke përdorur një program të thjeshtë redaktimi. Shtoni përshkrimin zanor në sfond dhe titrat. Testoni videon tuaj duke i kërkuar një personi tjetër që ta shikojë dhe të japë mendimin e tij/ saj në lidhje me të.

Gjërat që duhen patur parasysh

Në *YouTube* mund të gjeni shumë kanale për artet dhe zanatet, ushtrimet fizike, riparimin e objekteve, lojrat, punën në shtëpi dhe shumë të tjera. Për të nxënit në arsimin profesional videot më të vlefshme janë ato që lidhen drejtpërdrejt me një profesion dhe aftësi të caktuara që gjithsesi duhet të mësohen në arsimin profesional. Aty mund të gjeni shumë video demonstruese të mira për profesione të zakonshme si profesioni i [infirmierit](#). Ekzistojnë edhe kanale të tëra kushtuar një profesioni të vetëm. Edhe kompanitë e mëdha dhe prodhuesit e makinerive ofrojnë ndihmë dhe mbështetje në lidhje me produktet e tyre. Do të gjeni edhe kanale që janë krijuar nga një profesionist i vetëm i cili është i gatshëm të ndajë punën dhe idetë e tij / saj me të tjerët.

Sidoqoftë, disa video udhëzuese (*how-to*) nuk janë shumë të dobishme. Shumë shpesh problemi është tërësisht teknik dhe

mund të ishte zgjidhur me lehtësi. Vëmendja ndaj mënyrës së pozicionimit të kamerës dhe mënyrës së përdorimit të madhësive të imazhit për të treguar detajet luan një rol të madh. Edhe cilësia e audios, titujve dhe titrave është thelbësore për një video udhëzuese të suksesshme.

Modifikimi është një pjesë e prodhimit të videos që mund të marrë shumë kohë. Këto ditë ekzistojnë disa programe të thjeshta redaktimi dhe nëse nuk i keni përdorur më përpara, me siguri do të gjeni udhëzime të dobishme në internet në *YouTube* ose në faqen e internetit të kompanisë që e ka përgatitur programin.

Shembull i një programi të thjeshtë për redaktimin e videove pa pagesë:

- [Adobe Spark | Prezantimi](#)

Shembull i një videoje udhëzuese (*how-to*):

- [Si të përdorni: Demonstrimi i përdorimit të një Makine të Vietër Qepëse e markës Singer](#)

Detyrë mësimore 3#2: Demonstrimi i të nxënit ose i një aftësie

Rezultatet e të nxënit:

Ju

- njihni kompetencën
- demonstoni kompetencën ose aftësinë
- dokumentoni të nxënit dhe aftësinë

Teknikisht, kjo detyrë është në thelb e njëjtë me detyrën e mëparshme por qëllimi është i ndryshëm.

Zgjidhni aftësinë që dëshironi të demonstoni në video. Këtë herë qëllimi juaj është të tregoni veten si ekspert. Përdorni kurrikulën e fushës suaj profesionale. Aty do të gjeni shembuj të fushave të kompetencave dhe aftësive që duhet të zotërojnë një profesionist ose nxënës në fushën tuaj.

Kini parasysh që personi që do të shohë videon tuaj do të vlerësojë ekspertizën dhe cilësinë e punës tuaj. Pra, audiencia e synuar është mësuesi juaj ose ndoshta një punëdhënës i ardhshëm.

Pasi të keni krijuar videon, rishikojeni atë dhe vlerësoni nëse ju nxjerr si një person të kualifikuar. Reflektoni për veprimet tuaja në video dhe vlerësoni nëse mund të demonstoni, pa asnjë lloj dyshimi, se jeni kompetent në kryerjen e detyrës në video.

Alternativa të tjera

- Përgatisni një video-CV. Përgatisni videoklipe që portretizojnë aftësitë tuaja dhe ju si një profesionist në zanatin tuaj. Tregojani videon instruktorit ose bashkangjiteni atë tek CV-ja juaj.
- Vlerësoni kompetencën e një nxënësi tjetër duke parë një video të realizuar nga ata.

Gjërat që duhen patur parasysh

Videot udhëzuese (*how-to*) janë ndër videot më të njohura në internet. Videot udhëzuese të postuara nga përdorues të veçantë, profesionistë, shkolla dhe kompani mund të gjenden në faqet e videove, si *YouTube* si edhe në faqet e internetit të shkollave ose të kompanive.

Shikoni këto shembuj:

- [Makita Power Tools](#)
- [Kaynen Brown, Infermiera e Regjistruar](#)

Në arsimin dhe formimin profesional këto video janë shumë të dobishme. Meqenëse të njëjtat pajisje, materiale dhe metoda që përdoren nga profesionistët përdoren edhe nga nxënësit e shkollave profesionale, të njëjtat video udhëzuese mund të përdoren edhe në mësimin formal, joformal dhe informal. Videot udhëzuese po zëvendësojnë manualët dhe udhëzimet e shkruara.

Videot janë më të plotësuar sesa vetëm teksti dhe imazhet e palëvizshme për të demonstruar procesin dhe detajet e veprimit. Telefonat inteligjentë bëjnë të mundur që njerëzit të mund të shikojnë një video-bibliotekë të gjerë pothuajse kudo.

Nuk ka rëndësi nëse jeni vetëm, në punë apo në shkollë. E vërteta është që jo gjithmonë do të keni një person afër për t'ju ndihmuar me gjithçka që dëshironi të mësoni të bëni dhe mbase nuk dëshironi t'i shqetësoni ata me çdo pyetje që ju vjen në mend. Nga këndvështrimi i trajnuesit, një video mund të kursejë kohë dhe shmang përsëritjen.

Videot udhëzuese mund të tregojnë edhe modelin dhe cilësinë e një kompanie të vetme. Videot udhëzuese mund të përdoren për t'u siguruar që të gjithë punonjësit të njohin standardet dhe metodat e punës që kërkohen në kompani. Këto video i ndihmojnë punonjësit e rinj

dhe sigurohen që të gjithë ata persona që punojnë për organizatën kanë qasje tek i njëjti model dhe material mësimor.

Në arsimin e bazuar në kompetenca, nxënësit duhet të tregojnë dhe të vërtetojnë kompetencën e tyre. Një nxënës nuk mund të vërtetojë kompetencën e tij/saj dhe aftësitë e tij/saj nuk mund të vlerësohen vetëm duke shkruar ose treguar për ta. Demonstrimi i aftësive duhet të jetë po aq i vërtetë sa edhe në mjedisin e punës. Videoja është një mjet i shkëlqyeshëm për të dokumentuar kompetencat dhe aftësitë që demonstrohen në punë, për shembull.

Shembull i demonstrimit të aftësive në video:

- [Kontrolli i administrimit të ilaçeve](#)

VIDEOT
UDHËZUESE



Figura 4) Një pamje nga një video udhëzuese [Udhëzime për përdorimin e kamerës Sony HDR AX2000](#).

KAPITULLI 4: INTERVISTIMI I NJË PROFESIONISTI

Ky kapitull trajton të nxënit nga profesionistët e tjerë përmes intervistave, dhe mënyrën se si të adresoni situatat e vështira.

Detyrë mësimore 4#1: Një video- intervistë

Rezultatet e të nxënit:

Ju

- organizoni, planifikoni dhe kryeni një intervistë profesionale
- regjistroni në video dhe komunikoni perspektivën e një profesionisti
- dokumentoni të nxënit dhe aftësitë

Planifikoni pyetjet. Përgatitni pyetje të thjeshta të cilat janë të lehta për t'iu përgjigjur dhe që kanë lidhje me programin tuaj të studimit. Tre deri në pesë pyetje janë të mjaftueshme. Krijoni pyetje specifike dhe jo shumë të hapura me qëllim që të merrni përgjigjet e duhura. Përgatisni një listë me pyetje më personale, p.sh. "Pse e zgjodhët këtë profesion", dhe pyetje më të gjëra, p.sh. "Çfarë po ndryshon në punën tënde?" Përgjigjet me një ose dy fjalë nuk japin ndonjë informacion shumë interesant. Informojeni të intervistuarin tuaj paraprakisht në lidhje me pyetjet që do t'i drejtoni dhe ju mund t'i kujtoni ata që të përgjigjen në atë mënyrë që do t'ju lejojë të hiqni pyetjet tuaja gjatë redaktimit.

Gjeni një profesionist dhe intervistojeni përpara kamerës. Caktoni një vend për intervistën. Qëllimi është prezantimi i një profesioni ose i një vendi specifik pune.

Vendosja e kamerës

Në **Figurën 5#** mund të shihni vendosjen optimale të kamerës për një intervistë.

Zakonisht i intervistuari shikon intervistuesin gjatë regjistrimit (dhe jo kamerën). Nëse i intervistuari shikon kamerën, edhe emocioni i intervistës ndryshon. Ju ndoshta duhet të rregulloni pozicionet e të intervistuarit dhe kamerës në varësi të drejtimit nga shikon i intervistuari.

Regjistrimi i intervistës

Kërkojini të intervistuarit të flasë me ju, dhe jo direkt me kamerën. Nëse është e nevojshme ju mund të ndaloni regjistrimin në intervalin midis pyetjeve. Nëse i intervistuari juaj ngatërrohet me fjalët, ri-regjistroni pikërisht atë përgjigje. Redaktimi i sekuencave të shumëfishta është më i efektshëm sesa redaktimi i një sekuence të vetme të gjatë.

Ruani kontaktin sy më sy dhe reagoni ndaj përgjigjeve

edhe pse nuk do të shfaqeni në video. Reagimet tuaja bëjnë që i intervistuari të flasë më natyrshëm.

Redaktoni intervistën

Nëse merrni përgjigje që janë të qarta pa e dëgjuar pyetjen, ju mund të redaktoni dhe të hiqni atë pjesë ku dëgjoheni duke i drejtuar pyetjen. Nëse është e nevojshme, ju mund ta lini pyetjen tuaj ose mund ta shtoni atë në formë teksti në ekran.

Alternativa të tjera

- Nxënësit mund t'i kërkohej të intervistojë një punëtor ose një ekspert me qëllim marrjen e informacionit në lidhje me një çështje të caktuar, p.sh. siguria ushqimore, ose për të nxjerrë në pah një këndvështrim të caktuar, p.sh. këndvështrimin e klientit.
- Nxënësve mund t'iu kërkohej të intervistojnë individë që ushtrojnë të njëjtën profesion në organizata të ndryshme dhe më pas, duke punuar si ekip, të krijojnë një video që përdor dëshmitë e marra për të treguar se profesionistët mund të vijnë nga formime të ndryshme dhe mund të kenë funksione të ndryshme.
- Një video-blog mund të përgatitet vetëm. Në atë rast, personi thjesht flet me kamerën dhe i përgjigjet vetë pyetjeve.




Figura 5# Pozicioni i kamerës në një situatë intervistimi.

Gjërat që duhen patur parasysh

Intervistat janë një mënyrë e shkëlqyer për të krijuar një ide në lidhje me një profesion apo biznes. Regjistrimi në video i intervistave profesionale mbështet edhe elemente të tjera të të nxënit: për shembull, si të planifikoni çfarë duhet të dini në lidhje me personin e intervistuar; si t'i kontaktoni njerëzit; si të flisni me njerëzit; si të komunikoni. Videoja i motivon si nxënësin ashtu edhe profesionistin për ta marrë intervistën seriozisht.

Në arsimin profesional të nxëniet duhet të lidhet me punën sa më shumë që të jetë e mundur. Mënyra më e lehtë për ta realizuar këtë është duke shkuar në vendin e vërtetë të punës dhe duke bashkëpunuar me profesionistët që punojnë atje. Intervistat janë një mënyrë e mirë për të treguar se ju i vlerësoni njohuritë dhe intuitën e profesionistëve. Kjo është gjithashtu edhe një mënyrë e thjeshtë për të krijuar kontakte dhe për të siguruar rrjetëzimin. Për kryerjen e një interviste ju jeni të detyruar të përgatiteni. Përcaktoni një agjendë si edhe angazhoheni për një detyrë të përbashkët.

Video-intervistat janë një mjet për të nxënë përmes hulumtimit. Sidoqoftë, ato janë edhe një mjet për të zhvilluar aftësitë komunikuese, aftësitë për punën në ekip dhe reflektimin. Si një mjet i brendshëm për kompanitë, video-intervista na ndihmon të ndajmë me të tjerët informacione për profesionistët të ndryshëm në mënyrë të personalizuar dhe tërheqëse. Video-intervistat mund të kontribuojnë në edukimin për karrierën dhe në orientimin paraprak të praktikantëve. Krijimi i një ideje në lidhje me mënyrën se si organizatat dhe individët e paraqesin vetveten mund të kontribuojë në të kuptuarit kritik të imazhit dhe identitetit.

Shumë profesionistë kanë kënaqësinë të ndajnë mendimet e tyre me të tjerët, por ata mund të kenë rezerva kur flitet për regjistrimin e tyre me zë dhe figurë.

Për të marrë pëlqimin e tyre do t'ju duhet të shpjegoni qëllimin dhe audiencën e kësaj videoje. Punonjësit mund të kenë nevojë për leje nga eprorët e tyre. Të intervistuarit mund të tërhiqen pas përfundimit të videos ose mund të sugjerojnë redaktimin e saj. Pëlqimi është thelbësor dhe NUK ka problem nëse ju refuzojnë. Nga ana tjetër, ka shumë profesionistë që e vlerësojnë mundësinë për të përshkruar punën e tyre dhe për t'u shfaqur në video.

Shembull i një interviste të thjeshtë:

- [Menaxheri i Përgjithshëm i një Hoteli me 5 Yje - "Perspektivat për Karrierën"](#)

Edhe ndriçimi në video është një element sfidues. Vini re se si drejtimi i dritës ndikon në errësirën e figurës.

Detyrë mësimore 4#2: Filmimi në vende apo situata të vështira

Rezultatet e të nxëniet:

Ju

- kuptoni sigurinë dhe kufizimet e filmimeve në vende të caktuara
- merrni parasysh privatësinë dhe të drejtat e autorit

Rendisni vende ose situata të ndryshme që janë të zakonshme në profesionin tuaj.

Gjeni se çfarë kufizimesh mund të shkaktojnë konteksti dhe rrethinat fizike të profesionit tuaj për regjistrimin e materialit filmik. Për shembull, kur filmoni sipërfaqen e rrugës (ose duke shtruar asfalt), zhurma nga trafiku dhe makinat mund të jetë shumë e madhe. Për të treguar se si të përdorni një vinç, kameramanit mund t'i duhet të ngjitet në majën e vinçit. Edhe një mjedis shkollor në një klasë mund të jetë shumë i zhurmshëm ose i ndriçuar keq. Secili mjedis paraqet problemet e veta - shumica e të cilave mund të tejkalohen nëpërmjet planifikimit të kujdesshëm.

Gjeni se çfarë lejesh mund t'ju nevojiten për filmimin dhe publikimin e materialit tuaj.

Informohuni se cilat janë ato mjete që mundësojnë regjistrimin video dhe audio (me zë dhe me figurë) në një situatë sfiduese.

Alternativa të tjera

- Nxënësve mund t'iu kërkohet t'i shkruajnë një letër një punëdhënësi për t'i shpjeguar se si ata do të dëshironin të kryenin filmime në ambientet e biznesit, në mënyrë që të realizojnë një video e cila e rrit profilin publik të kompanisë.
- Grupeve të ndryshme të nxënësve mund t'iu kërkohet të intervistojnë punëtorë dhe ekspertë të ndryshëm në mjedisin e punës, duke krijuar një seri intervistash të lidhura së bashku sipas zanateve.

Gjërat që duhen patur parasysh

Edhe nëse do të arrini të menaxhoni të gjitha çështjet e planifikimit dhe të gjeni personin e duhur për intervistën, mund të jetë e vështirë të regjistroni në disa vende të caktuara. Natyrisht që videoja nuk duhet të përdoret në një vend ose situatë që përbën rrezik për sigurinë. Ju mund të përballeni me probleme të tilla si pluhuri, nxehtësia, i ftohti ose lagështia që mund të jenë të dëmshme për telefonat inteligjentë ose pajisjet e tjera regjistruese. Ndonjëherë mund të mos keni hapësirë të mjaftueshme fizike për të filmuar ose mund të ketë shumë zhurmë në sfond. Edhe pse ekzistojnë kamera kundër ujit dhe lloje të tjera mjeteve mbrojtëse, siguria duhet të vijë gjithmonë e para. Mund t'ju kërkohet të vishni pajisje sigurie, si helmata dhe çizme sigurie. Disa fabrika ose laboratorë nuk lejojnë që ambientet e tyre të regjistrohen në mënyrë kategorike. Nëse jeni rreth materialeve të rrezikshme ose në një kantier ndërtimi, ju ndoshta do t'ju duhet të lëvizni më tej dhe jo të qëndroni në atë vend.

Nëse duhet që duart dhe shqisat tuaja të përqendrohen në diçka tjetër, tek gatimi për shembull, atëherë kamera duhet të funksionojë automatikisht ose të përdoret nga një person tjetër.

Shpesh sfida më e madhe kur bëhet fjalë për filmime është marrja e lejes. Rastet kur materiali filmik është regjistruar dhe publikuar pa lejet e duhura kanë çuar në çështje ligjore! Vende të tilla si shkollat ose kopshtet janë sfidë për filmimet pasi ju nevojitet leje për regjistrimin dhe publikimin e materialit nga një kujdestar ligjor i secilit prej fëmijëve.

Kjo nënkupton se ju nevojitet shumë punë ose mund të nënkuptojë që thjesht nuk mund të filmoni në këtë ambient. Ia vlen që të përgatisni një fletë-leje. Nëse ka njerëz që nuk duan të shfaqen në videon tuaj në asnjë mënyrë, ju mund ta keni parasysh një gjë të tillë ndërkohë që planifikoni filmimin e videos tuaj. Në fund të këtij kapitulli gjeni një link të një fletë-leje ekzistuese.

Edhe ligjet për të drejtën e autorit duhet të merren parasysh. Shkeljet e mundshme të të drejtave të autorit përfshijnë përdorimin e muzikës së regjistruar ose materialeve të tjera filmike. Kjo është e rëndësishme nëse keni ndërmend të publikoni videon tuaj, për shembull, në *YouTube*.

Disa organizata, si spitalet për shembull, zakonisht nuk i lejojnë xhirimet ndërsa në disa të tjera, si një repart pune ose një studio projektimi, mund të haseni me problematika që kanë të bëjnë me shëndetin dhe sigurinë apo anën komerciale. Disa njerëz dhe organizata thjesht duan të kontrollojnë praninë e tyre në media. Është e rëndësishme që prodhuesit e videove t'i diskutojnë planet e tyre dhe të kenë dakordësinë e pjesëmarrësve.

Një shembull i një videoje të thjeshtë që kombinon *vlogging*, intervistimin dhe disa vende problematike:

- [Vizitë në Repartin e Punës me Ekipin e Ndërtimit - Makineria e Mermerit X #50](#)



Figura 6 Intervistë në këmbë. Një foto nga videoja [EDIT2015 – Sfidat e Videove Mësimore](#).

KAPITULLI 5: AKSESUESHMËRIA E VIDEOVE NË INTERNET

Ky kapitull trajton mënyrën e titrimit të një videoje, si ngarkohet ajo në një platformë në internet dhe sigurimin e aksesueshmërisë së videove.

Detyrë mësimore 5.1: Krijoni titrat në një video

Rezultatet e të nxënit:

Ju

- krijoni titrat në një video
- ngarkoni një video në *YouTube* (ose platformë të barasvlershme)
- jepni udhëzime për kryerjen e një detyre pune

Shikoni një video e cila tregon se si të kryeni një detyrë pune. Analizoni veprimin dhe përgatitni titra të shkurtra dhe të qarta që mund t'i shtoni në video për të sqaruar se çfarë duhet të bëhet dhe për të shmangur keqkuptimet e mundshme. Testojini këto udhëzime për t'u siguruar që funksionojnë. Pastaj duke përdorur një mjet redaktimi shtoni titrat në video dhe ngarkojeni atë në një video-platformë.

Udhëzime shtesë

Përdorni llogarinë tuaj në *Google*. Nëse nuk keni një të tillë, [krijoni një llogari të re](#). Një llogari *Google* është falas dhe ju lejon përdorimin e disa aplikacioneve dhe platformave të *Google*, si *YouTube*.

Ngarkoni në *YouTube* videon që keni realizuar. Përdorni kanalin tuaj në *YouTube*. Nëse nuk keni një të tillë, [krijoni një kanal të ri](#).

Nëse nuk keni një videon tuajën, ju mund të krijoni titra edhe për videot e personave të tjerë. Në këtë rast duhet të gjeni një video në *YouTube* që mund ta përktheni dhe titroni.

[Krijoni titra](#) për videon. Ndiqni udhëzimet dhe mijëra përdorues të *YouTube*.

Alternativa të tjera

Krijoni titra në gjuhë të tjera. Titrimi në gjuhë të huaj bën të mundur shkëmbimin e videove midis vendeve dhe komuniteteve të ndryshme.

Gjërat që duhen patur parasysh

Interneti është i mbushur me video, por jo domosdoshmërisht në gjuhën tuaj amtare. Sidomos në fushën profesionale, shumë nga videot janë të regjistruara vetëm në gjuhën angleze. Titrat janë një mjet i dobishëm për të kuptuar se për çfarë bëhet fjalë.

Edhe problemet që kanë të bëjnë me aksesueshmërinë përbëjnë shqetësim për ata persona që kanë aftësi të kufizuara. Ndonjëherë zëri mund të mos jetë aq i lartë sa duhet ose imazhet vizuale janë tepër të vogla ose nuk kanë kontrast të mjaftueshëm. Përdorimi i titrave mund të ndihmojë në rritjen e aksesit tek burimet e trajnimit.

Kufizimet dhe pengesat sa i takon aksesueshmërisë lidhen edhe me legjislacionin dhe rregulloret në shumë vende të ndryshme. Jo të gjitha materialet në internet mund të jenë të aksesueshme nga cilido vend. Ekzistojnë disa kufizime të vendosura nga politikë-bërësit lokalë si edhe nga pronarët e këtyre materialeve.

Edhe madhësia dhe cilësia e videove në internet mund të jetë një problem më vete. Nëse lidhja në internet është e dobët ose me kosto, kjo do të kufizojë qasjen.

Gjatë viteve të fundit zhvillimet teknologjike e kanë lehtësuar aksesueshmërinë. Për shembull, kompani si *Microsoft* dhe *Google* ofrojnë mjete që sigurojnë titra dhe përkthime automatike në shumë gjuhë të cilat mund të gjenerohen automatikisht dhe në situata të drejtpërdrejta dhe pastaj të redaktohen më vonë. Kjo kursen shumë kohë dhe fuqi punëtore.

Shembull në lidhje me aksesueshmërinë e përmbajtjes në internet:

- [Aksesueshmëria në YouTube: Publikimi i Përmbajtjes së Aksesueshme](#)



Figura 7.1 Titra në gjuhën angleze në një video mësimore në gjuhën finlandeze [Osaamisen opettajan jäljillä | Në kërkim të Kompetencës](#).

TITRAT

KAPITULLI 6: VIDEOT NXITËSE

Ky kapitull prezanton videot nxitëse të cilat mund të përdoren brenda dhe jashtë klasës. Videoja nxitëse është krijuar për të nxitur një veprimtari mësimore, p.sh. një diskutim, zgjidhje problemesh, një studim rasti.

Detyrë mësimore 6#1: Të mësosh me anë të videove nxitëse

Rezultati i të nxënës:

Ju

- gjeni një video të përshtatshme nxitëse dhe e përdorni atë për të nxitur diskutimin

Bëni një hulumtim dhe kërkoni video dhe filma që lidhen me profesionin tuaj. Planifikoni disa tema ose pyetje që mund të diskutohen pas ndjekjes së videos. Shikoni videon/videot dhe inkurajoni diskutimin në çift ose në grup.

Alternativa të tjera

- Klasat e rrokullisura - kërkoni nxënësve të shikojnë videon në shtëpi dhe më pas të udhëheqin diskutimin në shkollë.
- Kërkoni nxënësve të gjejnë një video të përshtatshme dhe pastaj të organizojnë diskutimet në grupe.

Shembujt e mëposhtëm mund të përdoren për të nxitur diskutimin dhe reflektimin:

- Reflektoni mbi praktikën tuaj pasi të shikoni videon [Vlera e Reflektimit mbi Praktikën](#).
- Diskutoni mbi sigurinë e vendit tuaj të punës bazuar në idetë e paraqitura në videon [Video për Sigurinë - 10 Rregullat për Sigurinë në Vendin e Punës](#).

Gjërat që duhen patur parasysh

Në këtë kontekst videoja nxitëse nënkupton një zinxhir ngjarjesh ose veprimesh të nxitura nga një video. Videoja nxitëse synon të fillojë ose të çojë në një aktivitet të strukturuar pas ndjekjes së videos ose të një pjese të videos. Qëllimi i videos është të japë disa ide fillestare ose të krijojë një bazë për diskutimin. Ndoshta shikuesi pritet të bëjë diçka praktike pas ndjekjes së videos. Kjo varet nga mënyra sesi përdoret videoja dhe si është projektuar aktiviteti pasues.

Ndërkohë që një video udhëzuese ose një demonstrim aftësie shfaqin modelin e një aktiviteti shumë specifik, në videot nxitëse shumë rrallë jepen udhëzime të hollësishme. Reagimet dhe aktivitetet që lindin si pasojë e videos mund të jenë nga më të ndryshmet.

Ato mund të specifikohen ose mund të lihen të hapura për mësuesin ose nxënësin. Videoja mund të sfidojë shikuesin për të ndryshuar mënyrën e punës ose të të menduarit.

Çdo video mund të përdoret si nxitëse - një film, një lajm ose një dokumentar, një video mësimore. Videot nxitëse kanë të bëjnë më shumë me mënyrën e përdorimit të tyre sesa me personin i cili e ka realizuar videon dhe arsyen përse. Megjithatë, ka video që janë prodhuar posaçërisht për të nxitur një aktivitet të caktuar - videot udhëzuese (*how-to*) janë shembuj shumë të qartë në këtë aspekt. Disa video tregojnë vetëm temën dhe pyetjet mund të trajtohen pas ndjekjes së videos.

Këtu janë disa shembuj nga bota e gatimit dhe restoranteve dhe disa ide se si mund t'i përdorni ato si video nxitëse:

- Shikoni një film si për shembull *The Chef* (Shefi i Kuzhinës), 2014, me regji të John Favreau ose *Jiro Dreams of Sushi*, 2011, me regji të David Gelp. Përdorni filmin si një shkas për të nxitur diskutimin mbi etikën ose vlerën dhe kuptimin e profesionit tuaj.
- Ju kanë mbaruar idetë për ëmbëlsirat? Krijoni versionin tuaj për njërin nga këto [25 recetat më të lehta 1-minutëshe për ëmbëlsirat](#)



Figura 8# Video nxitëse [AMOK Skits - Mësuesi Digjital](#).

VIDEOT
NXITËSE

KAPITULLI 7: INTERESAT E VEÇANTA - PËRMBAJTJA DHE VIDEO-MATERIALET INTERAKTIVE

Ky kapitull trajton gjeneratën e ardhshme të video-teknologjive në arsim, siç janë teknologjia VR dhe videot 360 gradë.

Në këtë kapitull nuk është dhënë një detyrë mësimore por mësuesit inkurajohen të kërkojnë më shumë informacion mbi idetë e prezantuara këtu. Nuk është nevoja që të bëni investime fillestare, pasi në internet mund të gjeni shumë shembuj ilustrues.

Teknologjitë e reja po shfaqen çdo vit. Disa risi tashmë janë të konsoliduara dhe disa të tjera ndoshta nuk do të mund të njihen kurrë. Sidoqoftë, është e mundur të mësoni si nga novacionet në zhvillim e sipër ashtu edhe nga praktikat e konsoliduara. Testimi i këtyre teknologjive mund të shërbejë si një mundësi shtesë mësimore për një fushë të caktuar profesionale. Ekspozitat tregtare, dyqanet e TI dhe aktivitetet në lidhje me teknologjinë shpesh ju ofrojnë mundësinë për të provuar teknologjinë e re.

H5P dhe videot interaktive

Teknologjia H5P u jep mundësinë të gjithëve që të krijojnë materiale filmike (video) interaktive në internet me shumë lehtësi. As krijuesi i përmbajtjes interaktive dhe as përdoruesi fundor nuk kanë nevojë të programojnë elementët ndërveprues. Ndërfaqja e përdoruesit është e thjeshtë. Për shembull, me mjetet H5P mund të tërhiqni dhe të vendosni elementë të ndryshëm ndërveprues në krye të një videoje në YouTube. Përdoruesi nuk ka nevojë të përdorë ndërfaqen e YouTube apo të modifikojë videon.

<https://h5p.org/interactive-video>

Shumica e videove në internet janë relativisht të shkurtra dhe ato më të gjatat mund të anashkalojnë lehtësisht. Kjo e bën më të vështirë nxitjen e veprimeve me anën e një videoje. Pikërisht në këtë rast na vijnë në ndihmë mjetet H5P. Këto mjete, për shembull, ju ndihmojnë të ndaloni videon dhe iu shfaqin një sërë pyetjesh në një moment të caktuar kohor në video. Shikuesi nuk mund të vazhdojë videon derisa t'i përgjigjet saktë pyetjeve. Kjo do ta bëjë procesin e shikimit më interaktiv dhe do të sigurojë në një farë mase përqendrimin e shikuesit tek përmbajtja e videos dhe reagimin e tij në mënyrë aktive.

Videoja 360

Numri i kamerave që bëjnë të mundur që përdoruesit të regjistrojnë një pamje 360 gradë rreth tyre është i madh. Videot 360 gradë mund të publikohen në YouTube. Ato mund të shikohen me kufje të realitetit virtual ose me një kuti të thjeshtë kartoni të Google me një telefon celular modern brenda saj.

Shumica e modeleve të fundit të telefonave inteligjentë lejojnë shikimin e videove 360 gradë. Ju ndryshoni pamjen që shihni në video duke e kthyer telefonin. Ju mund të shikoni video 360 gradë edhe në YouTube në një monitor normal kompjuteri. Ju ndryshoni këndin e shikimit me butonat W, A, S, D ose duke e zvarritur 'miun' mbi video.

Kjo lloj teknologjie ofron mundësi interesante. Kamera 360 gradë regjistron gjithçka rreth saj dhe më vonë, ndërsa shikojmë videon ne zgjedhim se në cilin drejtim duam të shikojmë. Kjo përdoret për qëllime mbikëqyrjeje por mund të përdoret edhe për të kontrolluar hapësirat e punës ose për të diagnostikuar problemet.

Një shembull tjetër është përdorimi i vizitave virtuale. Ne praktikisht mund të shkojmë në vende që përndryshe nuk do të kishim mundësi t'i vizitonim. Ndoshta është një vendndodhje tjetër gjeografike ose mjedis i vështirë pune si një platformë për nxjerrjen e naftës ose një minierë nëntokësore. Pamja 360 gradë mund të transmetojë informacion vizual dhe sensin e hapësirës. Dhe mbase në të ardhmen e afërt, numri i paisjeve që do të kontrollohen nga larg do të jetë më i lartë - tashmë ekzistojnë disa aplikacione të njohura me dronë.

Një shembull i një videoje 360 gradë:

- [Toyota VR / 360° Vizitë në Fabrikë](#)

Hipervideoja

Ndërkohë që ende nuk kemi as edhe një përkufizim të fjalës 'hipervideo', do të ishte më e lehtë nëse e përshkruajmë atë si një term paralel me hipertekstin. Kur hiperteksti është një element ndërveprues i hiperlidhur, hipervideoja është material filmik me lidhje interaktive që lejojnë vendosjen dhe lidhjen e elementeve ose aplikacioneve të ndryshme në një video. Dikush mund të ketë për shembull pikat e nxehta (*hot spots*), lidhjet me mediat sociale si Twitter, gjurmimin e elementeve, aplikacionin *picture-in-picture* apo skedarët e shkarkueshëm bashkangjitur në një video. Ajo ka shumë ngjashmëri me teknologjinë H5P dhe YouTube tashmë e lejon praninë e këtyre linqeve në videot e tyre.



Figura 90 Videoja 360 gradë [Një Orë Tipike Mësimi – Video 360 Gradë në Arsim](#).

Ndoshta këto aplikacione duan ende kohë për t'u bërë pjesë e jetës sonë. Ju mund të krijoni një ide duke shikuar imazhet 360 gradë në [Google Tour Creator](#) dhe madje të krijoni edhe materialet tuaja duke e përdorur atë.

Shembull i një hipervideoje të krijuar me [iVideo.education](#):

- [Gestione cliente](#) (Menaxhimi i klientëve)

[Registrohuni](#) për të filluar me përdorimin e [iVideo.education](#) pa pagesë.

Realiteti i shtuar dhe i përzier

Videoja është vetëm një element i teknologjive të realitetit të shtuar dhe të përzier. Kur përziejme përmbajtjen virtuale me realitetin fizik, duke parë përmes ekranit të *Microsoft HoloLens* ose diçka të ngjashme, ne mund të shohim një shtresë të videos mësimore mbi botën aktuale fizike. Tashmë ekzistojnë aplikacione ku një element nxitës në hapësirën ose objektin fizik mund të sinjalizojë ekzistencën e një përmbajtjeje virtuale të shtuar që lidhet me një vend ose objekt të caktuar. Ndoshta rasti më i njohur është kodi QR. Shumë video mësimore ose përmbajtje të realitetit të shtuar tanimë shkëmbehen në këtë mënyrë.

Aplikacionet e teknologjisë AR (realiteti i shtuar) / MR (realiteti i përzier) / VR (realiteti virtual) / XR (realiteti i zgjeruar) janë interesante. Imagjinoni sikur ju hapni kofanon e makinës tuaj dhe përmes një ekranit që keni veshur arrini të

shihni motorin të ilustruar me fjalë që ju tregojnë pjesët e tij, shihni udhëzime të animuara të pjesëve të ndryshme të motorit dhe dëgjoni një zë orientues. Ky është pikërisht ai lloj i AI-së (inteligjenca artificiale) që do të ndihmojë shumë njerëz të menaxhojnë detyra që normalisht do të kërkojnë shumë kohë dhe trajnim ose pajisje të shtrenjta demonstruese.

Shembull që demonstroi *Microsoft HoloLens*:

- [Microsoft HoloLens: Realiteti i Përzier i Kombinon Hologramet me Botën Reale](#)





Figura 10 Një shembull i realitetit të shtuar i parë në një tabletë. Imazhi nga [pixabay.com](#).